



NDËRMARRJA PUBLIKE
“Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës – INFRAKOS” SH.A.

RAPORT VJETOR
2025¹

Prezantoi “INFRAKOS” SH. A.
Fushë Kosovë, Mars 2026

¹ Raport Nr. Prot. 2/40 i datës 26.03.2026



NDËRMARRJA PUBLIKE
“INFRASTRUKTURA E HEKURUDHAVE TË KOSOVËS – INFRAKOS” SH. A.

Adresa: “Sheshi Lirisë” nr. 36 Fushë Kosovë tel. +383 38 550 550 500 www.infrakos.com

Në mbështetje të Neni 31 paragrafi 3 dhe neni 14 të Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike si dhe neni 7, neni 18 i Ligji Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 4, neni 7 paragrafi 2, neni 14 i Ligji Nr. 06/L-087 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, ndërlidhur me neni 28 pika 6 të Kodit të Etikes dhe Qeverisjes Korporative si dhe nenit 15 paragrafit 15.2.3 të Statutit Nr.2/80 të Ndërmarrjes Publike të “Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës – INFRAKOS” SH.A datës 17.12.2025, Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike “Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës - INFRAKOS” SH.A. në takimin e mbajtur më datë 26.03.2026, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen Pasqyrat Financiare 2025 të Ndërmarrjes Publike “Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës – INFRAKOS” SH. A.
2. Aprovohet Raporti Vjetor 2025 i Ndërmarrjes Publike “Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës – INFRAKOS” SH. A.
3. Konform pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi, Sekretarja Korporative obligohet të procedoj tutje në NJPMNP-ME.
4. Vendimi hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit²

Znj. Besarta ZUKA
Besarta ZUKA

U.D. Kryesuese e Bordit të Drejtorëve
 N.P. “Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës
 INFRAKOS” SH.A.

Vendimi i dërgohet:

- Kryeshefit Ekzekutiv
- Departamentit të Financave;
- NJPMNP-ME.

² Vendimi Nr. Prot. 2/38 i Bordit të Drejtorëve të datës 26.03.2026

PËRMBAJTJA

Hyrje	4
INFRASTUKTURA HEKURUDHORE NË KOSOVË	5
1.1. Historiku i Infrastrukturës Hekurudhore në Kosovë	5
1.2. Zhvillimi i Infrastrukturës Hekurudhore në Kosovë	5
1.3. Muzeu i Hekurudhave të Kosovës	7
QEVERISJA KORPORATIVE	8
2.1. Deklarata e vizionit, objektivat dhe strategjitë kyçe	8
2.2. Bordi i Drejtorëve	9
2.3. Raporti i U. D. Kryesues së Bordit të Drejtorëve	10
2.4. Raporti i U. D. Kryeshefes Ekzekutive	11
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	14
3.1. Sektori i Komunikacionit	15
3.2. Kontrolli i Brendshëm dhe Komisioni për Opinione dhe Pëlqime	17
3.3. Sektori i Pronës	18
3.4. Burimet Njerëzore	20
3.5. Zyra Ligjore	20
PËRFORMANCA FINANCIARE	22
4.1. Planifikimi dhe realizimi i të hyrave	22
4.2. Shpenzimet NP “INFRAKOS” SH.A.	24
4.3. Krahasimi i shpenzimeve dhe të hyrave	24
4.4. Pasqyrat Financiare 2025	25
4.5. Shpenzimet kapitale dhe projektet	29
MENAXHIMI I RREZIQEVE	32
PËRMBUSHJA E PLANIT TË BIZNESIT	33

HYRJE

Raporti Vjetor i Ndërmarrjes Publike “Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës – INFRAKOS” SH.A. për vitin 2025, përfaqëson dokumentin kryesor të llogaridhënies mbi aktivitetin teknik, operativ dhe financiar të ndërmarrjes. Ky raport është hartuar me qëllim që t’i ofrojë Aksionarit, institucioneve mbikëqyrëse dhe partnerëve ndërkombëtarë, një pasqyrë transparente dhe të argumentuar mbi gjendjen e infrastrukturës hekurudhore në Republikën e Kosovës. Për t’u orientuar sa më mirë lexuesi duhet të dijë se ky raport është i strukturuar në gjashtë shtylla kryesore që zërthejnë rrugëtimin e NP “INFRAKOS” SH.A. gjatë vitit raportues.

Raporti nis me një retrospektivë të zhvillimit të hekurudhave në Kosovë, duke vënë theksin te roli i Muzeut të Hekurudhave. Ky seksion shërben për të kuptuar peshën historike të ndërmarrjes dhe rëndësinë e ruajtjes së aseteve që kanë formësuar identitetin e transportit kombëtar. Qeverisja Korporative dhe Udhëheqja Strategjike prezanton ndryshimet në strukturat menaxhuese, rolin e Bordit të Drejtorëve dhe deklaratat e vizionit. Këtu përfshihen raportet e Kryesuesit të Bordit dhe Kryeshefes Ekzekutive, të cilët ofrojnë një vlerësim kritik mbi arritjet dhe sfidat strategjike, duke përfshirë reformat e brendshme dhe përputhshmërinë me kërkesat e qeverisjes së ndërmarrjeve publike. Performanca Operative dhe Shfrytëzimi i Infrastrukturës përmban të dhëna teknike mbi gjendjen e linjave të hapura, stacionet dhe objektet përcjellëse. Lexuesi gjen analiza të detajuara mbi transportin e mallrave dhe udhëtarëve, shfrytëzimin e kapaciteteve nga operatorët e licencuar dhe sfidat e shpejtësisë së lëvizjes në rrjetin aktual. Menaxhimi i Pronës dhe Financave i kushton një pjesë substanciale të raportit menaxhimit të pronave hekurudhore dhe të hyrave nga qiradhënia, si një burim jetik për likuiditetin e ndërmarrjes. Këtu pasqyrohen bilancet financiare, realizimi i subvencioneve nga Qeveria dhe efikasiteti në mbledhjen e të hyrave në raport me shpenzimet operative. Investimet Kapitale dhe Modernizimi paraqet progresin në rehabilitimin e linjës hekurudhore Hani i Elezit – Leshak. Lexuesi informohet mbi projektet e financuara nga institucionet financiare ndërkombëtare BERZH dhe BEI, si dhe grantet e BE-së, si dhe për punimet në mirëmbajtjen e linjave ekzistuese Fushë Kosovë – Pejë dhe Klinë – Prizren. Siguria, Çështjet Ligjore dhe Burimet Njerëzore trajton sigurinë në trafikun hekurudhor dhe analizën e aksidenteve. Gjithashtu ofrohet pasqyrë mbi lëndët gjyqësore në proces, menaxhimin e kontratave të prokurimit dhe politikat e burimeve njerëzore, duke përfshirë strukturën e stafit dhe kualifikimet e tyre.

Përmes kësaj përmbajtjeje, INFRAKOS SH.A. dëshmon angazhimin e saj për të transformuar infrastrukturën ekzistuese në një rrjet modern, të sigurt dhe të integruar në korridoret evropiane, duke mbajtur lart standardet e profesionalizmit dhe përgjegjësisë publike.

INFRASTUKTURA HEKURUDHORE NË KOSOVË

1.1. Historiku i Infrastrukturës Hekurudhore në Kosovë

Zhvillimi i transportit hekurudhor në Kosovë fillon në fund të shekullit XIX dhe përbën një nga elementet më të rëndësishme të zhvillimit të transportit dhe ekonomisë së vendit. Vija e parë hekurudhore në Kosovë u ndërtua në vitin 1874, në relacionin Hani i Elezit – Fushë Kosovë – Mitrovicë, duke shënuar fillimin e zhvillimit të rrjetit hekurudhor në vend. Zhvillimi i mëtejshëm i rrjetit hekurudhor vazhdoi gjatë dekadave në vijim. Në vitin 1931 u ndërtua linja Mitrovicë – Leshak, ndërsa në vitin 1934 u realizua linja Fushë Kosovë – Prishtinë. Në vitin 1936 u ndërtua linja Fushë Kosovë – Pejë, ndërsa më vonë rrjeti u zgjerua edhe me linjat Prishtinë – Podujevë – Livadhi në vitin 1949 dhe Klinë – Prizren në vitin 1963.

Në periudhat e hershme të zhvillimit të transportit, hekurudha kishte një rol dominues në transportin tokësor dhe ishte transportuesi kryesor për mallra dhe udhëtarë. Megjithatë, me zhvillimin e transportit rrugor dhe rritjen e përdorimit të automjeteve, roli i transportit hekurudhor filloi të zvogëlohej gradualisht. Pas vitit 1990, me integrimin e dhunshëm të hekurudhave të Kosovës në sistemin e hekurudhave të Serbisë dhe gjatë periudhës së bllokadës ekonomike deri në vitin 1999, aktiviteti i transportit hekurudhor u reduktua ndjeshëm. Pas përfundimit të luftës në Kosovë në vitin 1999, sektori hekurudhor u vendos fillimisht nën administrimin e forcave të KFOR-it, të cilat menaxhuan operimin e hekurudhave deri në vitin 2002. Në këtë vit, menaxhimi i ndërmarrjes ju transferua administratës së UNMIK-ut, dhe ndërmarrja filloi të operojë me emrin “Hekurudhat e UNMIK-ut”.

Në vitin 2005 ndërmarrja ndryshoi statusin e saj ligjor dhe u transformua në Shoqëri Aksionare me emrin “Hekurudhat e Kosovës” Sh. A.. Në kuadër të reformave të sektorit hekurudhor dhe në përputhje me praktikën evropiane për ndarjen e menaxhimit të infrastrukturës nga operimi i trenave, në shtator të vitit 2011 ndërmarrja amë u nda në dy ndërmarrje të veçanta, NP “INFRAKOS Sh. A., përgjegjëse për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore, dhe NP ”TRAINKOS” Sh. A., përgjegjëse për operimin e transportit hekurudhor të udhëtarëve dhe mallrave. Kjo ndarje synonte rritjen e efikasitetit të sektorit hekurudhor dhe harmonizimin e tij me praktikën dhe standardet e Bashkimit Evropian.

1.2. Zhvillimi i Infrastrukturës Hekurudhore në Kosovë

Rrjeti hekurudhor në Republikën e Kosovës shtrihet në të gjithë territorin e vendit dhe përbëhet nga rreth 333 km linjë e hapur hekurudhore, rreth 105 km binarë në stacione, si dhe mbi 100 km vija industriale. Edhe pse jo i gjithë rrjeti është aktualisht në shfrytëzim të plotë, infrastruktura hekurudhore siguron lidhje ndërkombëtare përmes pikave kufitare me shtetet fqinje.

Në veri dhe lindje rrjeti hekurudhor lidhet me Serbinë përmes Leshakut dhe Podujevës, ndërsa në jug lidhet me Maqedoninë e Veriut përmes Hanit të Elezit. Një nga linjat më të rëndësishme është Linja Hekurudhore 10 (Hani i Elezit – Leshak), e cila lidh Kosovën me Korridorin Pan-Evropian X, duke krijuar mundësi për integrim më të madh në rrjetin evropian të transportit.

Megjithatë, infrastruktura hekurudhore në Kosovë përballlet me sfida të konsiderueshme për shkak të mungesës së investimeve për një periudhë të gjatë. Në shumë segmente të rrjetit, shpejtësia maksimale e lejuar është e kufizuar deri në 60 km/h, ndërsa disa linja, si Prishtinë – Podujevë dhe Klinë – Prizren, janë

jashtë funksionit për shkak të dëmtimeve. Modernizimi dhe rehabilitimi i rrjetit hekurudhor përbën një nga prioritetet kryesore për zhvillimin e sektorit të transportit në Kosovë³.




Fig. 1: Harta e Rrjetit Hekurudhorë të Kosovës

Kosova, si pjesë e iniciativave rajonale për zhvillimin e transportit dhe si anëtare e SEETO (South East Europe Transport Observatory), ka përfshirë disa nga rrugët dhe linjat hekurudhore të saj në Rrjetin Rajonal të Transportit. Në kuadër të këtij bashkëpunimi dhe përmes mbështetjes së institucioneve financiare ndërkombëtare dhe Bashkimit Evropian, janë siguruar fonde të konsiderueshme për modernizimin e rrjetit hekurudhor. Një nga projektet më të rëndësishme është rehabilitimi i Linjës Hekurudhore 10, me një kosto totale prej rreth 208.4 milionë euro. Financimi i këtij projekti është siguruar përmes një kombinimi kredish dhe grantesh nga institucione ndërkombëtare, përfshirë Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Bankën Evropiane të Investimeve (BEI), Bashkimin Evropian, si dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës. Projekti i rehabilitimit të kësaj linje është planifikuar të realizohet në tri faza: Faza I - Hani i Elezit – Fushë Kosovë; Faza II - Fushë Kosovë – Mitrovicë Jugore; Faza III - Mitrovicë Jugore – Leshak. Pas përfundimit të rehabilitimit, shpejtësia maksimale e trenave në këtë linjë pritet të arrijë deri në 100 km/h, duke përmirësuar ndjeshëm kapacitetin dhe sigurinë e transportit hekurudhor. Gjithashtu janë realizuar studime dhe projekte për zhvillimin e linjave të tjera hekurudhore, përfshirë projekt-dizajnin preliminar për Linjën Hekurudhore 7, si dhe studimin e fizibilitetit për lidhjen hekurudhore Prishtinë – Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, të financuara përmes granteve nga WBIF (Western Balkans Investment Framework).

³ Strategjia Sektoriale dhe Transportit Multimodal 2015-2025 dhe Plan i veprimit 5 vjeçar, fq.58

1.3. Muzeu i Hekurudhave të Kosovës

Një dimension tjetër i rëndësishëm i NP “INFRAKOS” SH. A. është ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore përmes Muzeut të Hekurudhave të Kosovës⁴. Ky i fundit është një institucion unik në vend, i cili ruan dhe prezanton trashëgiminë historike, kulturore dhe teknike të transportit hekurudhor në Kosovë. Ai u krijua për të dokumentuar dhe përkujtuar evolucionin e ngadalshëm të hekurudhorit, përpjekjet e tij për të ndërtuar, mirëmbajtur dhe zhvilluar rrjetin hekurudhor, si dhe për të lidhur të kaluarën me të tashmen dhe të ardhmen e sektorit. Ideja për krijimin e këtij muzeu lindi në shtator të vitit 2006 dhe u konkretizua më 24 gusht 2007, me inaugurimin solemn ku morën pjesë punonjës të Hekurudhave të Kosovës, përfaqësues të Qeverisë së Kosovës, UNMIK-ut dhe KFOR-it. Në këtë muze u mbledhën dhe u sistemuan libra, dorëshkrime, vegla, vula, dokumente dhe fotografi të vjetra dhe bashkëkohore që ilustrojnë historinë dhe zhvillimin e transportit hekurudhor në vend. Ekspozitat janë renditur sipas kritereve profesionale dhe janë të aksesueshme për publikun e gjerë, duke u ofruar vizitorëve një përvojë edukative dhe kulturore të pasur.

Muzeu luan një rol të rëndësishëm në edukimin e fëmijëve, nxënësve dhe studentëve, si dhe në promovimin e trashëgimisë teknike për vizitorët ndërkombëtarë. Ai nuk është thjesht një hapësirë për ekspozim, por edhe një depo e kujdesshme për koleksionet historike, duke mbrojtur objektet nga humbja dhe dëmtimi, dhe duke i rikthyer vlerën estetike dhe kulturore të tyre.

Përveç ruajtjes së së kaluarës, muzeu ndihmon në përforcimin e besimit të publikut në rëndësinë dhe rolin e Hekurudhave të Kosovës, duke theksuar kontributin e punonjësve dhe dashamirësve të artit dhe teknologjisë hekurudhore. Si një institucion që ndërthur edukimin, kulturën dhe historinë, Muzeu i Hekurudhave të Kosovës është bërë një destinacion i rëndësishëm për vizitorët e të gjitha moshave, duke siguruar që pasardhësit të kenë qasje në këtë trashëgimi të çmuar dhe duke e vendosur muzeun si një komponent kyç në promovimin dhe ruajtjen e identitetit historik dhe kulturor të sektorit hekurudhor në Kosovë⁵.



Fig. 2: Foto nga Muzeu i Hekurudhave të Kosovës

⁴ <https://infrakos.com/muzeu/>

⁵ <https://infrakos.com/muzeu/ekspozitat-muzeu/>

QEVERISJA KORPORATIVE

2.1. Deklarata e vizionit, objektivat dhe strategjitë kyçe

Deklarata e vizionit, objektivat dhe strategjitë kyçe të NP “Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës – INFRAKOS” Sh. A. paraqesin orientimin strategjik dhe drejtimin afatgjatë të zhvillimit të ndërmarrjes. Nëpërmjet këtyre parimeve, ndërmarrja synon të sigurojë funksionim efikas, zhvillim të qëndrueshëm dhe përmirësim të vazhdueshëm të infrastrukturës hekurudhore në Republikën e Kosovës. Duke pasur parasysh rëndësinë e transportit hekurudhor për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, NP “Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës – INFRAKOS” Sh. A. angazhohet që përmes planifikimit strategjik, menaxhimit profesional dhe investimeve në infrastrukturë të krijojë kushte të përshtatshme për operimin e transportit hekurudhor në përputhje me standardet evropiane.

Vizioni i INFRAKOS është që infrastruktura hekurudhore e Kosovës të zhvillohet në një rrjet modern, të sigurt dhe konkurrues, i cili do të ofrojë shërbime cilësore dhe të besueshme për të gjithë operatorët e transportit hekurudhor. Në këtë drejtim, ndërmarrja synon të modernizojë dhe përmirësojë vazhdimisht rrjetin ekzistues hekurudhor, duke e bërë atë më atraktiv dhe më efikas për transportin e mallrave dhe udhëtarëve. Përmes zhvillimit të vazhdueshëm dhe përshtatjes me standardet dhe praktikatat e Bashkimit Evropian, INFRAKOS synon të bëhet një ndërmarrje e besueshme dhe konkurruese në rajonin e Ballkanit Perëndimor në ofrimin e infrastrukturës hekurudhore, duke garantuar qasje të barabartë, transparente dhe jodiskriminuese për të gjithë operatorët e transportit hekurudhor.

Objektivat e INFRAKOS janë të orientuara drejt zhvillimit dhe modernizimit të infrastrukturës hekurudhore, rritjes së sigurisë dhe efikasitetit në operimin e rrjetit, përmirësimin të menaxhimit dhe mirëmbajtjes së aseteve hekurudhore, si dhe forcimit të kapaciteteve profesionale të stafit dhe bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare për zhvillimin e projekteve strategjike në sektorin hekurudhor.

Strategjitë kyçe të INFRAKOS janë të fokusuar në zhvillimin dhe rehabilitimin e linjave hekurudhore ekzistuese, përmirësimin e sistemeve të sinjalizimit dhe telekomunikacionit hekurudhor, si dhe avancimin e praktikave të menaxhimit të infrastrukturës dhe mirëmbajtjes së saj. Përmes investimeve në projekte infrastrukturore dhe përmes bashkëpunimit me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë, ndërmarrja synon të rrisë kapacitetin dhe efikasitetin e rrjetit hekurudhor dhe të kontribuojë në integrimin e Kosovës në rrjetet rajonale dhe evropiane të transportit. Nëpërmjet zbatimit të këtyre strategjive, INFRAKOS synon të krijojë një sistem hekurudhor të qëndrueshëm dhe konkurrues që do të përmbushë nevojat e shoqërisë dhe ekonomisë së Kosovës në të ardhmen.

2.2. Bordi i Drejtorëve

Qeverisja korporative në Ndërmarrjen Publike “Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës – INFRAKOS” Sh. A. bazohet në parimet e transparencës, përgjegjësisë dhe llogaridhënies, në përputhje me legjislacionin në fuqi Ligji për Ndërmarrjet Publike⁶, Ligji për Shoqëritë Tregtare⁷, si dhe praktikatat e mira sipas Kodit të Qeverisjes Korporative⁸. Në këtë kuadër, Bordi i Drejtorëve përfaqëson organin më të lartë mbikëqyrës dhe vendimmarrës të ndërmarrjes, i cili ka përgjegjësi për orientimin strategjik të ndërmarrjes dhe për mbikëqyrjen e punës së menaxhmentit ekzekutiv. Përmes funksionimit të tij, Bordi siguron që aktivitetet e ndërmarrjes të zhvillohen në mënyrë efikase dhe në përputhje me interesin publik, si dhe në harmoni me objektivat strategjike të zhvillimit të sektorit hekurudhor në Kosovë.

Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike “Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës – INFRAKOS” Sh. A. gjatë vitit kalendarik 2025 ka pas këtë përbërje:

- Kryesuese e Bordit të Drejtorëve – znj. Edona Nahi;
- Zv. Kryesuese e Bordit të Drejtorëve – znj. Besarta Zuka;
- Drejtor i Bordit të Drejtorëve – z. Genc Hundozi;
- Drejtor i Bordit të Drejtorëve – z. Fitim Raci;
- Kryeshef dhe anëtar i Bordit – z. Naser Krasniqi;

Më 16 janar 2026 z. Naser Krasniqi në cilësinë e Kryeshefit, i ka skaduar mandati⁹, kurse Ushtruese e Detyrës së Kryeshefes Ekzekutive emërohet¹⁰ znj. Syleme Ahmeti Bllaca, që aktualisht mban pozitën e Zyrtares Kryesore Financiare dhe të Thesarit. Gjithashtu për të siguruar mbarëvajtjen e proceseve financiare sipas ligjit, Ushtrues i Detyrës së Zyrtares Kryesore Financiar dhe të Thesarit është emëruar¹¹ z. Agim Aliu. Gjithashtu, me datë 29 janar 2026 znj. Edona Nahi, në përputhje me elementin vulltiv ka dhënë dorëheqje nga pozita e Kryesues së Bordit të Drejtorëve, andaj, Ushtruese e Detyrës së Kryesueses së Bordit të Drejtorëve¹² është caktuar znj. Besarta Zuka. Gjatë vitit raportues, Bordi i Drejtorëve ka mbajtur mbledhje të rregullta dhe sipas nevojës edhe mbledhje të jashtëzakonshme për të trajtuar çështje të ndryshme që lidhen me zhvillimin dhe funksionimin e ndërmarrjes. Në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, Ligjin për Shoqëritë Tregtare, Kodit të Qeverisjes Korporative si dhe Statutit Ndërmarrjes Publike “Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës – INFRAKOS” Sh. A., Bordi i Drejtorëve ka mbajtur gjashtëmbëdhjetë (16) Mbledhje, ku trembëdhjetë (13) prej tyre Mbledhje të Rregullta, dy (2) prej tyre Mbledhje të Jashtëzakonshme dhe një (1) Mbledhje Vjetore me Aksionarin. Në këto mbledhje janë diskutuar dhe miratuar brenda afateve ligjore të përcaktuara raporte të parapara me dispozitat ligjore në fuqi, vendime të rëndësishme që kanë të bëjnë me performancën operative dhe financiare të ndërmarrjes, politikat e brendshme të menaxhimit dhe çështje të tjera me rëndësi strategjike. Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve janë zhvilluar në mënyrë të rregullt, me pjesëmarrje aktive të anëtarëve, duke siguruar një proces vendimmarrjeje transparent dhe të përgjegjshëm. Përkatësisht gjatë vitit raportues 2025 Bordi i Drejtorëve ka nxjerrë njëzet (20) vendime.

⁶ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2547>

⁷ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16426>

⁸ https://me.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/07/KODI_i_qeverisjes_korporativeSHQIP_2014.pdf

⁹ Vendim Nr. Prot. 2/03 i Bordit të Drejtorëve të datës 16.01.2026

¹⁰ Vendim Nr. Prot. 2/04 i Bordit të Drejtorëve të datës 16.01.2026

¹¹ Vendim Nr. Prot. 2/13 i Bordit të Drejtorëve të datës 30.01.2026

¹² Vendim Nr. Prot. 132 i Ministres së Ekonomisë të datës 30.01.2026

2.3. Raporti i U. D. Kryesues së Bordit të Drejtorëve



Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës – INFRAKOS Sh.A. mbetet një ndër asetet më të rëndësishme strategjike të Republikës së Kosovës, me rol të pazëvendësueshëm në zhvillimin ekonomik dhe në ndërtimin e një sistemi modern dhe të qëndrueshëm të transportit. Gjatë kësaj periudhe raportuese, INFRAKOS ka vazhduar të avancojë në përmbushjen e misionit të saj, duke kontribuar në zhvillimin e rrjetit hekurudhor në përputhje me standardet evropiane dhe prioritetet kombëtare. Ky vit ka qenë një periudhë e angazhimit serioz institucional, ku janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt përmirësimit të performancës financiare dhe menaxhimit më efikas të burimeve. Pavarësisht sfidave të pranishme, veçanërisht në raport me nivelin e aktivitetit të operatorëve hekurudhorë, ndërmarrja ka arritur të ruajë stabilitetin dhe të forcojë bazat për zhvillim të qëndrueshëm në të ardhmen. Një moment me rëndësi të veçantë është nënshkrimi i marrëveshjes pesëvjeçare financiare me Qeverinë e Republikës së Kosovës, e cila krijon një siguri më të madhe për planifikimin strategjik dhe realizimin e projekteve zhvillimore. Në të njëjtën kohë, vlen të theksohet se aksionari ka shprehur qartë përkushtimin për t'i dhënë prioritet sektorit hekurudhor, duke e pozicionuar atë si një nga shtyllat kryesore të zhvillimit të ardhshëm të infrastrukturës në vend. Ky është një mesazh i fuqishëm mbështetjeje dhe një nxitje e rëndësishme për të gjithë ne që punojmë në këtë sektor.

INFRAKOS ka vazhduar të fokusohet në projektet kyçe zhvillimore, në veçanti në rehabilitimin dhe modernizimin e Linjës 10, një projekt me rëndësi strategjike për lidhjen e Kosovës me rrjetet rajonale dhe evropiane. Progresi i arritur, përkundër sfidave, dëshmon për përkushtimin institucional dhe për bashkëpunimin e suksesshëm me partnerët ndërkombëtarë. Në të njëjtën kohë, janë bërë hapa të rëndësishëm në forcimin e kontrollit të brendshëm dhe përmirësimin e menaxhimit financiar, duke reflektuar një qasje më të avancuar në drejtim të transparencës, llogaridhënies dhe integritetit institucional. Bordi i Drejtorëve ka ushtruar rolin e tij mbikëqyrës në mënyrë aktive dhe të përgjegjshme, duke mbështetur menaxhmentin dhe duke siguruar që ndërmarrja të mbetet e orientuar drejt objektivave strategjike dhe zhvillimit afatgjatë.

Në përmbyllje, besoj fuqishëm se e ardhmja e sektorit hekurudhor në Kosovë është premtuese. Me mbështetjen e shtetit, me përkushtimin institucional dhe me bashkëpunimin me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë, INFRAKOS do të vazhdojë të zhvillohet si një ndërmarrje moderne, e besueshme dhe në shërbim të qytetarëve dhe ekonomisë së vendit.

Singerisht,

U. D. Kryesuese e Bordit të Drejtorëve

Znj. Besarta ZUKA

2.4. Raporti i U. D. Kryeshefes Ekzekutive

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës – INFRAKOS SH.A, në përputhje me legjislacionin në fuqi, bën menaxhimin e rrjetit hekurudhor të Republikës së Kosovës, me një vizion të qartë për të ofruar shërbime të standardeve të larta për të gjithë operatorët e transportit hekurudhor. Objektivi ynë strategjik mbetet krijimi i një rrjeti hekurudhor konkurrues dhe të qëndrueshëm financiarisht, në përputhje me zhvillimet rajonale dhe në funksion të përmbushjes së nevojave të shoqërisë dhe ekonomisë së Kosovës.

Ndërmarrja Publike “INFRAKOS” SH. A. vazhdon aktivitetin e saj në një rrjet hekurudhor në proces të rehabilitimit dhe modernizimit, me investime që synojnë ngritjen e standardeve teknike dhe operacionale në nivelin e kërkuar të tregut dhe rajonit. Të mbështetur nga Qeveria e Kosovës, Bashkimi Evropian, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Banka Evropiane e Investimeve (BEI), po vazhdon zbatimin e projekteve zhvillimore në infrastrukturën hekurudhore. Gjatë vitit 2025, është arritur progres i dukshëm në zbatimin e fazës I dhe II të rehabilitimit të Linjës së 10-të Hekurudhore, përkundër sfidave të hasura gjatë zhvillimit të punimeve, çështjeve fiskale dhe mospërputhjeve me kontraktorin në disa pika të caktuara. Përfundimi dhe funksionalizimi i Linjës 10-të Hekurudhore mbetet prioriteti kryesor i Ndërmarrjes, pasi kjo linjë ka rëndësi strategjike ndërkombëtare dhe ndikim të drejtpërdrejtë në të gjithë sektorin hekurudhor të vendit.

Krahas projekteve aktuale, është hartuar një plan zhvillimor afatmesëm që përfshin rehabilitimin e linjave: Fushë Kosovë – Pejë, Klinë – Prizren, Prishtinë – Aeroport dhe Prishtinë – Merdare me qëllim që ri funksionalizohet plotësisht rrjeti hekurudhor ekzistues. Gjithashtu, në kuadër të vizionit dhe planeve afatgjata, është paraparë edhe zhvillimi i projekteve ideore dhe studimeve për linja të reja hekurudhore si linja Ferizaj – Gjilan – Preshevë, si dhe koordinimi për linjën Durrës – Prishtinë, një projekt i cili tashme ka kaluar fazën e projektimit ideor e që paraqet potencial madhor zhvillimor kombëtar dhe rajonal.

Këto iniciativa dëshmojnë vizionin e ndërmarrjes për zhvillim dhe modernizim të rrjetit hekurudhor që interoperabiliteti me rrjetin rajonal dhe me gjerë të jetë në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian dhe objektivat strategjike të sektorit hekurudhor. Ndërmarrja Publike “INFRAKOS” SH. A. ka përmblyllur edhe vitin 2025 me performancë pozitive, duke konfirmuar vijimësinë e trendit të suksesit dhe forcimin e stabilitetit të ndërmarrjes. Këto rezultate janë arritur falë zbatimit të politikave efektive menaxheriale, të cilat kanë rezultuar me rritjen e të hyrave nga qiratë, rritjen e efikasitetit ligjor dhe operacional, menaxhimin racional të shpenzimeve, shmangien e obligimeve pa mbulim financiar, forcimin e bashkëpunimit me ndërmarrjet publike dhe rritjen e kontroleve të brendshme. Është me rëndësi të veçohet se ky rezultat pozitiv është arritur edhe pa u përmbushur plotësisht detyrimet financiare të marrëveshjes pesëvjeçare nga aksionari, çka nënkupton se NP “INFRAKOS” SH.A. ka kontribuar drejtpërdrejt në ruajtjen e buxhetit të shtetit. Pavarësisht arritjeve, gjatë vitit 2025 NP “INFRAKOS” SH. A. është përballur me sfida komplekse në procesin e Rehabilitimit të Linjës së 10-të Hekurudhore. Për këtë qëllim, këtë fillim vit janë propozuar zgjidhje adekuate dhe janë ndërmarrë hapa për koordinim shumëdimensional me të gjithë aktorët e përfshirë, për tejkalim të barrierave dhe përfundim të projektit brenda afateve sa me të shpejta. Për të arritur këtë, kërkohet një koordinim proaktiv i veprimeve me aksionarin dhe të gjithë akteret e përfshirë.

Në cilësinë e U.D. Kryeshefes Ekzekutive, theksoj se NP “INFRAKOS” SH.A. vepron duke u mbështetur në parimet e ligjshmërisë, llogaridhënies, transparencës dhe përshtatshmërisë ekonomike, me një qasje

proaktive në funksion të përmbushjes së misionit dhe vizionit të ndërmarrjes. Rrjeti hekurudhor paraqet një vlerë të shtuar për vendin, për shërbime publike ndaj qytetarëve dhe një alternative më ekonomike, mjedisore dhe sociale për transport të sigurt dhe efikas. Vizioni, misioni dhe objektivat e ndërmarrjes paraqesin një orientim të qartë për një të ardhme që siguron perspektivë, zhvillim dhe ofrim të shërbimeve në përputhje me kërkesat ligjore vendore dhe standardet rajonale. Objektiva këto që do të realizohen përmes politikave të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve, koordinimit me aksionarin, përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara dhe përkushtimin e stafit të ndërmarrjes.

Gjatë vitit 2025, Ndërmarrja Publike “Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës – INFRAKOS” Sh. A. ka zhvilluar një sërë aktivitesh me rëndësi për avancimin e sektorit hekurudhor dhe forcimin e kapaciteteve institucionale të ndërmarrjes.

- ❖ Një zhvillim tjetër me rëndësi strategjike ishte përmbijllja e studimit të fizibilitetit dhe dizajnit preliminar për linjën hekurudhore Prishtinë – Durrës, një projekt i përbashkët ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. Ky projekt konsiderohet me potencial të madh për zhvillimin ekonomik dhe për forcimin e lidhjeve infrastrukturore dhe tregtare në rajon.



Fig. 3: Projekti i Linjës Hekurudhore Prishtinë - Durrës

- ❖ Në drejtim të përmirësimit të sigurisë në rrjetin hekurudhor, gjatë vitit 2025 është realizuar inaugurimi dhe funksionalizimi i sistemeve të sigurisë në disa vendkalime në nivel rrugë-hekurudhë në linjën hekurudhore Fushë Kosovë – Pejë. Ky projekt, i financuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ka kontribuar në rritjen e sigurisë në komunikacion dhe në zvogëlimin e rrezikut të aksidenteve në vendkalimet hekurudhore.
- ❖ Gjatë kësaj periudhe, INFRAKOS ka vazhduar gjithashtu punimet në Rehabilitimin e Linjës 10-të Hekurudhore, një nga projektet më të rëndësishme infrastrukturore në vend. Aktivitetet kanë përfshirë zhvillimin e punimeve në fazat e projektit, ndërtimin e objekteve infrastrukturore dhe restaurimin e stacioneve hekurudhore përgjatë kësaj linje.
- ❖ Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, INFRAKOS ka zhvilluar takime edhe me përfaqësues të Ambasadës së Finlandës dhe kompani teknologjike finlandeze, me qëllim shkëmbimin e

përvojave dhe identifikimin e mundësive për bashkëpunim në projekte që lidhen me modernizimin e infrastrukturës hekurudhore dhe integrimin e teknologjive inovative në sektorin e transportit.

- ❖ Një nga zhvillimet e rëndësishme ishte nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet INFRAKOS Sh. A. dhe Toka Management LLC, i cili synon zhvillimin e kapaciteteve profesionale të stafit dhe avancimin e njohurive në fushën e mirëmbajtjes dhe operimit të infrastrukturës hekurudhore. Në kuadër të këtij bashkëpunimi janë organizuar edhe aktivitete trajnuese për stafin teknik të ndërmarrjes, me pjesëmarrjen e ekspertëve ndërkombëtarë.

Përmes këtyre aktiviteteve, INFRAKOS ka vazhduar të përforcojë rolin e saj në zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore dhe në krijimin e kushteve për një sistem transporti më të sigurt, efikas dhe në përputhje me standardet bashkëkohore.

Singerisht.

U.D. Kryeshefe Ekzekutive

Znj. Syleme AHMETI BLLACA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ndërmarrja Publike “Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës – INFRAKOS” Sh.A. ushtron aktivitetin e saj në menaxhimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore në Republikën e Kosovës, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe mandatin e saj institucional në sektorin e transportit. Në aspektin e veprimtarisë ekonomike, ndërmarrja është e regjistruar për disa aktivitete të lidhura me transportin dhe shërbimet mbështetëse të tij, duke përfshirë aktivitetet e transportit hekurudhor, trajtimin e transportit të mallrave, aktivitetet mbështetëse të transportit, magazinimin, si dhe menaxhimin dhe qiradhënien e patundshmërisë. Megjithatë, në praktikë burimet kryesore të të hyrave të ndërmarrjes gjenerohen vetëm nga dy segmente kryesore të aktivitetit: nga tarifatat për përdorimin e infrastrukturës hekurudhore nga operatorët e transportit të udhëtarëve dhe nga të hyrat e realizuara përmes qiradhënies së pronave dhe hapësirave që janë në menaxhim të ndërmarrjes. Këto dy burime përbëjnë bazën kryesore të të hyrave të NP “INFRAKOS” SH. A. dhe janë të ndërlidhura drejtpërdrejt me funksionimin e rrjetit hekurudhor dhe me menaxhimin efikas të aseteve të ndërmarrjes.

Gjatë vitit 2025, INFRAKOS Sh. A. ka zhvilluar aktivitetet e saj në një gamë të gjerë veprimtarish që ndërlidhen me funksionimin dhe zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore në Republikën e Kosovës. Përmes analizave të rregullta dhe monitorimit të vazhdueshëm të proceseve operacionale dhe financiare, ndërmarrja ka synuar të sigurojë funksionim të qëndrueshëm institucional dhe të shmangë rreziqet që mund të ndikojnë në performancën e saj. Një vëmendje e veçantë gjatë kësaj periudhe i është kushtuar menaxhimit të gjendjes financiare të ndërmarrjes. Përmes trajtimit të rregullt të pasqyrave financiare dhe planifikimit të kujdesshëm të të hyrave dhe shpenzimeve, janë ndërmarrë vendime menaxheriale dhe strategjike me qëllim të ruajtjes së likuiditetit dhe funksionimit të qëndrueshëm financiar të ndërmarrjes. Në kuadër të planifikimit dhe organizimit të aktivitetit të ndërmarrjes, gjatë vitit 2025 është hartuar edhe *Ekspozëu i Rrjetit për vitin 2026*, një dokument i rëndësishëm që përcakton kushtet teknike dhe operacionale për përdorimin e rrjetit hekurudhor nga operatorët e transportit. Ky dokument paraqet një instrument kyç për funksionimin e tregut hekurudhor dhe për krijimin e të hyrave nga përdorimi i infrastrukturës hekurudhore. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe është hartuar edhe *Plani i Biznesit për vitin 2026*, i cili përfshin objektivat strategjike dhe operacionale të ndërmarrjes për periudhën njëvjeçare. Ky plan është përgatitur në përputhje me kërkesat e Ministrisë së Ekonomisë dhe rekomandimet e Njësisë për Politikën dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike, duke reflektuar prioritetet zhvillimore dhe orientimin strategjik të ndërmarrjes.

Në përgjithësi, gjatë vitit 2025 NP “INFRAKOS” SH. A. ka trajtuar një sërë çështjesh që lidhen me zhvillimin institucional, planifikimin strategjik dhe menaxhimin operacional të ndërmarrjes, me qëllim të sigurimit të funksionimit të qëndrueshëm dhe krijimit të kushteve për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit hekurudhor në Republikën e Kosovës.

3.1. Sektori i Komunikacionit

Sektori i Komunikacionit në kuadër të Departamentit Teknik dhe të Komunikacionit ka pasur rol kyç në funksionimin e përditshëm të rrjetit hekurudhor gjatë vitit 2025. Ky sektor ka qenë përgjegjës për organizimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e qarkullimit të trenave në rrjetin hekurudhor të INFRAKOS-it, duke ofruar shërbime për operatorët e transportit hekurudhor, përkatësisht NP "TRAINKOS" Sh.A. dhe operatorin privat RAILTRANS.

Përmes një angazhimi të vazhdueshëm 24 orësh, sektori ka siguruar organizimin dhe mbikëqyrjen e qarkullimit të trenave të udhëtarëve dhe të mallrave, duke garantuar respektimin e orarit të lëvizjes së trenave dhe funksionimin e sigurt të komunikacionit hekurudhor. Falë këtij angazhimi, gjatë vitit 2025 nuk janë evidentuar vonesa të theksuara apo ndërprerje të qarkullimit të trenave si rezultat i menaxhimit të komunikacionit nga INFRAKOS. Gjithashtu, sektori ka trajtuar me efikasitet kërkesat e operatorëve për trase të jashtëzakonshme të trenave, duke mundësuar futjen në qarkullim edhe të trenave të paplanifikuara në orarin e rregullt.

Në kuadër të menaxhimit të rrjetit hekurudhor, shërbimi për qasje në rrjet ka monitoruar në mënyrë të vazhdueshme qarkullimin e mjeteve hekurudhore dhe ka realizuar llogaritjen dhe faturimin e tarifave për përdorimin e infrastrukturës hekurudhore dhe shërbimeve tjera të ofruara për operatorët e transportit. Të hyrat nga qasja në rrjet përbëjnë një nga burimet kryesore financiare të ndërmarrjes. Gjatë vitit 2025 ka vazhduar gjithashtu operimi i Terminalit të Mallrave në stacionin hekurudhor në Miradi, i cili mbetet terminali i vetëm hekurudhor në Kosovë për ngarkim dhe shkarkim të kontejnerëve dhe mallrave të tjera. Ky terminal ka qenë në dispozicion të operatorëve dhe tregut gjatë gjithë vitit, duke ofruar shërbime për transportin e mallrave përmes rrjetit hekurudhor. Sa i përket sigurisë në komunikacionin hekurudhor, gjatë vitit 2025 janë evidentuar disa raste të jashtëzakonshme në rrjetin hekurudhor. Të gjitha këto raste janë trajtuar nga komisioni profesional i përbashkët i INFRAKOS-it dhe TRAINKOS-it, si dhe janë njoftuar institucionet kompetente, përfshirë Komisionin për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore dhe Policinë e Kosovës. Sipas raporteve profesionale të përgatitura pas hetimeve përkatëse, në asnjë nga rastet e evidentuara përgjegjësia nuk i është atribuar INFRAKOS-it.

Në vijim janë paraqitur në formë tabelore të dhënat mbi qarkullimin e trenave të udhëtarëve dhe mallrave, të hyrat nga qasja në rrjet, aktivitetet e terminalit të mallrave, si dhe rastet e jashtëzakonshme të evidentuara gjatë vitit 2025, duke përfshirë edhe krahasimin me vitin paraprak.

Tabela 1: Trenat e Udhëtarëve

TRENAT E UDHËTARËVE					
Krahasimi i trenave	Numri i trenave të planifikuara	Trenat e rregullt të realizuar	Trenat ad hok	Trenat e revokuar	Numri i trenave të realizuar
	1	2	3	4=1-2	5=2+3
Viti 2025	2190	2173	4	17	2177
Viti 2024	2196	2187	19	9	2206
Diferenca (2025-2024)	-6	-14	-15	8	-29

Tabela 2: Trenat e Mallrave

TRENAT E MALLRAVE					
Krahasimi i trenave	Numri i trenave të planifikuar	Trenat e rregullt të realizuar	Trenat ad hok	Trenat e revokuar	Numri i trenave të realizuar
	1	2	3	4=1-2	5=2+3
Viti 2025	1420	0	37	1420	37
Viti 2024	2032	8	22	2024	30
Diferenca (2025-2024)	-612	-8	15	-604	7

Tabela 3: Të hyrat nga qasja në binarë nga Operatori NP "TRAINKOS" SH.A.

TË HYRAT NGA OPERATORI NP "TRAINKOS" SH.A.							
Viti	Trena të udhëtarëve	Trena të rregullt të Mallrave	Trena të rregullt Ad-hok të Mallrave	Trena me orare të posaçme	Shërbime tjera te trenave udhëtarëve	Shërbime tjera të Trenave të mallrave	Të hyrat e përgjithshme
Viti 2025	155,352.06	37.30	104.82	0.00	10,949.90	2,332.82	168,776.90
Viti 2024	156 854,34	47.46	586.60	0,00	11,279.76	4 059,12	172 827,28
Diferenca (2025-2024)	-1,502.28	-10.16	-481.78	0.00	-329.86	-1,726.30	-4,050.38

Tabela 4: Të hyrat nga qasja në binarë nga Operatori Privat RAILTRANS

TË HYRAT NGA OPERATORI RAILTRANS					
Viti	Trena të rregullt të Mallrave	Trena jo të rregullt Ad-hok të Mallrave	Trena me orare të posaçëm	Shërbime të tjera	Të hyrat e përgjithshme
Viti 2025	30.46	0.00	0.00	20.00	50.46
Viti 2024	0.00	0.00	0.00	00.00	0.00
Diferenca (2025-2024)	30.46	0.00	0.00	20.00	50.46

Tabela 5: Qasja në Terminal

TË HYRAT NGA QASJA E TERMINALIT							
	Numri i Kontejnerëve	Numri e Vagonëve	Të hyrat nga Krani	Qëndrimi i Mallit	Të hyrat Piruneri	Të hyrat Fletëhyrjet	Totali i të Hyrave
Viti 2025	0	0	160.00	0	0.00	100.00	260.00
Viti 2024	0	0	0.00	0	60.00	120.00	180.00
Diferenca (2025-2024)	0	0	160.00	0	-60.00	-20.00	80.00

Tabela 6: Aksidentet Hekurudhore

AKSIDENTET HEKURUDHORE							
Ngjarjet e jashtëzakonshme	Numri i aksidenteve	Aksidentet në vendkalime	Aksidentet në stacione dhe linjë të hapur	Vlera e dëmeve materiale hekurudhore	Auto të dëmtuara	Numri i personave të vdekur	Numri i personave të lënduar
Viti_2025	13	12	1	7,011.00€	13	1	9
Viti_2024	7	4	3	6,537.00€	4	2	5
Diferenca (2025-2024)	6	8	-2	474.00€	9	-1	4

3.2. Kontrolli i Brendshëm dhe Komisioni për Opinione dhe Pëlqime

Raporti i Kontrollorit të Brendshëm për vitin 2025 përmbledh aktivitetet e mbikëqyrjes dhe kontrollit të të gjithë sektorëve ekzekutiv të NP "INFRAKOS" SH.A. Ky kontroll është kryer me qëllim të garantimit të cilësisë së shërbimeve, sigurisë së infrastrukturës hekurudhore dhe respektimit të standardeve të brendshme operative. Gjatë vitit 2025, aktiviteti i Kontrollorit të Brendshëm përfshiu:

- Kontrollin rutinë në stacionet hekurudhore;
- Monitorimin dhe inspektimin e linjave hekurudhore;
- Mbikëqyrjen e stafit ekzekutiv dhe funksionimit të sektorëve përgjegjës.

Puna e kontrollorit ka qenë aktive dhe sistematike, duke mundur identifikimin në kohë të mangësive dhe rekomandimin e masave për përmirësim. Pas secilit inspektim janë hartuar raporte të detajuara dhe janë njoftuar me shkrim personat përgjegjës, gjë që ka kontribuar në rritjen e efikasitetit operativ dhe të cilësisë së shërbimeve të ofruara.

Në kuadër të mekanizmave të menaxhimit të të hyrave dhe të pronës së INFRAKOS-it, funksionon Komisioni për Dhënie të Opinioneve dhe Pëlqimeve. Ky komision shqyrton dhe trajton kërkesat nga palët e treta që lidhen me ndërhyrjet në pronën e INFRAKOS-it dhe trupin hekurudhor, duke siguruar që çdo intervenim të jetë në përputhje me rregullat dhe procedurat ligjore, si dhe duke gjeneruar të hyrat për ndërmarrjen. Ky mekanizëm mbikëqyrjeje dhe koordinimi është thelbësor për të ruajtur integritetin e rrjetit hekurudhor, për të siguruar efikasitet në operacione dhe për të mbështetur qëllimet strategjike të INFRAKOS-it në sigurimin e një infrastrukture hekurudhore të sigurt dhe funksionale.

Tabela 7: Kërkesat e shqyrtuara nga Komisioni për Opinione dhe Pëlqime

KOMISIONI PËR OPINIONE DHE PËLQIME						
TOTALI KËRKESAVE	Kërkesat e shqyrtuara	Kërkesat në procedurë	Opinione	Pëlqimet	Refuzimet	Kërkesa të tërhequra
117	114	3	47	41	13	13

3.3. Sektori i Pronës

Gjatë vitit 2025, Sektori i Pronës i INFRAKOS-it ka funksionuar me përkushtim maksimal për të menaxhuar të gjitha çështjet e pronës dhe për të siguruar realizimin e të hyrave në mënyrë efektive. Rezultatet e arritura tregojnë një trend pozitiv dhe afër maksimizimit të potencialit të të hyrave nga aktivitetet e sektorit, duke theksuar nevojën për vëmendje të vazhdueshme dhe mirëmbajtje të këtij niveli performancë. Aktivitetet dhe rezultatet kryesore të sektorit përfshijnë:

- ❖ Hartimin dhe përditësimin e kontratave vazhduese për vitin 2025, duke siguruar transparencë dhe rregullsi në marrëdhëniet me qiramarrësit.
- ❖ Definimin dhe administrimin e faturave të tatimit në pronë për 14 komuna, duke shmangur kamata dhe ndëshkime të mundshme.
- ❖ Përgatitjen e shkresave dhe njoftimeve për klientët lidhur me kryerjen e borxheve, si dhe për organet komunale për kërkesa të ndryshme, përfshirë pajisjen me certifikata të pronës.
- ❖ Realizimin e dy shpalljeve publike për dhënien e pronave dhe objekteve të lira me qira.
- ❖ Trajtimin e 143 kërkesave të pranuar gjatë vitit, duke përfshirë kërkesat për marrje të pronës me qira, ndërprerje të faturimit, ndryshime të emrit ose bartësit të kontratës, dhe kërkesa për pëlqime lidhur me ndërtime.
- ❖ Nënshkrimin e 377 kontratave sipas procedurave të përcaktuara, duke garantuar formalitetet ligjore dhe efektivitetin e qarkullimit të pronës.
- ❖ Shpërndarjen e rregullt të faturave mujore për klientët dhe trajtimin e njoftimeve për lirime të pronave, ku disa kanë rezultuar pozitive dhe disa janë proceduar në zyrën ligjore për mosgjykim ose mungesë përgjigjeje.
- ❖ Menaxhimin e situatave të veçanta, përfshirë pezullimin e disa kontratave për shkak të punimeve në stacionin e trenit në Fushë, si dhe ndërprerjen e gjashtë kontratave nga qiramarrësit për arsye të pamundësisë për shfrytëzim.

Falë këtyre veprimeve, të hyrat nga qiratë për vitin 2025 kanë arritur një nivel të lartë, duke realizuar 1,465,564.00 €, duke tejkaluar planifikimin vjetor dhe duke konfirmuar efektivitetin e menaxhimit të pronës nga NP "INFRAKOS" SH.A. Kjo performancë demonstroi përkushtimin e vazhdueshëm të Sektorit të Pronës për të siguruar një administrim të qëndrueshëm dhe të qëndrueshëm të aseteve të ndërmarrjes, duke mbështetur në mënyrë të drejtpërdrejtë qëllimet strategjike të kompanisë.

Tabela 8: Të hyrat nga të drejtat pronësore të NP "INFRAKOS" SH.A.





Tabela 9: Aktivitetet e për realizimin e të hyrave

AKTIVITETET NË SEKTORIN E PRONËS	
Kontrata të bizneseve dhe banesave për vitin 2025	377
Kontratat e reja të bizneseve dhe të banesave	27
Ndërprerje të kontratave	24
Kërkesat për marrje te pronës me qira	143
Shkresa, kërkesa, komunave	6
Njoftime për lirim prone	34
Njoftimet për përmbushjen e detyrimeve	149
Propozime për te zyra ligjore	23
Ankesa	13
Opinione për kontrata	60
Shpallje publike për dhënie te pronës me qira	22

3.4. Burimet Njerëzore

Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Menaxhimit të Punonjësve ka zhvilluar një aktivitet të vazhdueshëm



gjatë vitit 2025 për të përmbushur objektivat strategjike të INFRAKOS-it dhe për të siguruar një strukturë të qëndrueshme të stafit. Në fillim të vitit, ndërmarrja ka pasur 218 punonjës, ndërsa më 31 dhjetor ky numër ka qenë 204, prej të cilëve 184 me kontrata në afat të pacaktuar dhe 20 me kohë të caktuar. Struktura gjinore dhe etnike tregon një përqendrim kryesisht tek meshkujt (189 meshkuj, përfshirë 3 nga komuniteti serb dhe 1 nga komuniteti ashkali) dhe 15 femra (prej tyre 1 nga komuniteti serb). Gjatë vitit, 16

punonjës kanë përfunduar marrëdhëniet e punës (pensionime, dorëheqje, përfundim kontrate dhe ndërprerje të marrëdhënies), ndërsa janë punësuar 2 të rinj për plotësimin e nevojave operative. Sektori ka menaxhuar me kujdes rastet e paraqitura në Inspektoratin e Punës, duke ndjekur procedurat ligjore dhe duke aplikuar ankime kur ka qenë e nevojshme. Përmes një menaxhimi të kujdesshëm të forcës punëtore, ky sektor ka kontribuar në krijimin e një ambienti pune të qëndrueshëm dhe efikas, zbatimin e drejtë dhe transparent të ligjit për marrëdhëniet e punës, stabilitetin e stafit dhe përgatitjen për nevojat e ardhshme. Aktivitetet e sektorit kanë ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e performancës operative, rritjen e efikasitetit dhe forcimin e kulturës institucionale të llogaridhënies dhe përgjegjësisë profesionale.

Tabela 10: Ngritja e kapaciteteve dhe trajnime për stafin e NP "INFRAKOS" SH.A.

Fusha e trajnimit		Nr. i orëve
1	Siguria dhe shëndeti në punë, mbrojtja nga zjarri	338h
2	Shkollimi stafit hekurudhor	288h
3	Sinjalizim i dukurive negative	16h
4	Burime njerëzore	15h
5	Mirëmbajtja e Infrastrukturës hekurudhore	44h
6	Prokurim	136h
7	Zhvillimet nga fusha e komunikacionit/transportit dhe mirëmbajtjes	32h
8	Financa dhe Auditim i brendshëm	32h
TOTALI		901h

3.5. Zyra Ligjore

Zyra Ligjore gjatë vitit 2025 ka vazhduar të mbështesë funksionimin e INFRAKOS-it përmes përfaqësimit ligjor, këshillave juridike, opinioneve dhe asistencës në hartimin e akteve të ndërmarrjes, duke siguruar që vendimmarrja dhe aktivitetet e përditshme të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjatë këtij viti, në procedurat ligjore aktive janë menaxhuar 343 lëndë, ku INFRAKOS ka qenë paditës në 272 raste dhe i paditur në 71 raste, janë regjistruar 31 lëndë të reja dhe janë përfunduar 41 raste, prej të cilave 22 në favor të ndërmarrjes. Në procedurë përbarimore, janë menaxhuar 257 lëndë aktive, me 240 raste ku INFRAKOS ka qenë kreditor dhe 17 raste si debitor; gjatë vitit janë inicuar 30 lëndë të reja përbarimore dhe janë përfunduar 16 raste, ku 14 kanë qenë në favor të ndërmarrjes. Për lëndët e vjetra, disa procedura kanë mbetur të pezulluara për shkak të mungesës së të dhënave, duke kërkuar një angazhim të shtuar në ekzekutimin e tyre.

Gjatë vitit janë zhvilluar 81 seanca gjyqësore dhe janë përgatitur parashtresa të ndryshme ligjore, ndërsa nga gjykatat kanë ardhur 77 vendime, ku 55.8% kanë qenë në favor të INFRAKOS-it. Në procedurë përmbartimore janë inicuar raste me një vlerë totale prej 807,991.37 €, ndërsa kundër ndërmarrjes është dorëzuar një propozim për përmbartim prej 71,328.74 €.

Përveç përfaqësimit ligjor, Zyra Ligjore ka kontribuar në hartimin e rregulloreve dhe akteve të brendshme të ndërmarrjes, në udhëheqjen e komisionit disiplinor dhe të trajtimit të ankesave. Në vazhdimësi është punuar në azhurnimin dhe zhvillimin e bazës së të dhënave për lëndët në gjykata dhe procedurë përmbartimore, duke ofruar menaxhmentit një pasqyrë të qartë të rrezikut dhe trendëve ligjorë, si dhe duke mbështetur vendimmarrjen strategjike të ndërmarrjes.




Tabela 11: Pasqyra e lëndëve në procedurë gjyqësore

PASQYRA E LËNDËVE GJYQËSORE			
Lëndët gjyqësore		Nr. lëndëve	Vlera në %
Lloji i kontestit	Civile	302	88.0%
	Penale	18	5.2%
	Marrëdhënie Pune	23	6.7%
Ekspozimi financiar			
NP "INFRAKOS" SH.A. si palë në procedurë	Paditës	272	1,731,898.09€
	E paditur	71	4,340,829.46€
TOTAL		343	6,072,727.55€
SHKALLA E RREZIKUT	LARTË	MESËM	ULËT
	52	211	80
	15%	62%	23%

PËRFORMANCA FINANCIARE

Ndërmarrja Publike “Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës - INFRAKOS” SH.A. gjendjen financiare gjatë vitit 2025 e ka pasur tepër të vështirë dhe angazhimi i Ndërmarrjes në fushën financiare gjatë tërë vitit ka qenë i fokusuar në mbikëqyrjen e të hyrave dhe shpenzimeve, ashtu që Ndërmarrja të mund të funksionojë në kushte të jashtëzakonshme. Rënia e të hyrave nga pagesat e qasjes në rrjet për shkak të rënies së transportit të mallrave nga operatorët e transportit hekurudhorë, si dhe ndërprerja e qarkullimit dhe pamundësisë së operimit në Linjën 10 Hekurudhore, segmenti Fushë Kosovë – Hani i Elezit, për shkak të Rehabilitimit të Linjës 10 Hekurudhore, si dhe mungesa e përfitimit të subvencionit nga Marrëveshja pesëvjeçare me Ministrinë e Ekonomisë, Qeveria e Republikës së Kosovës, për Ndërmarrjen ka qenë sfidë dhe ka sjellë një situatë jo të mirë financiare.

4.1. Planifikimi dhe realizimi i të hyrave

- **Të hyrat nga shfrytëzimi i Rrjetit TM** – si një ndër kategoritë e të hyrave që derivojnë nga qasja në rrjet nga operatorët e transportit hekurudhor, gjatë vitit 2025 janë realizuar në vlerë prej 2,041.00€. Kjo përfaqëson 238% të buxhetit të planifikuar prej 604.00€, duke reflektuar tejkalim të konsiderueshëm të planit. Në aspektin krahasimor me vitin 2024, kur të hyrat nga kjo kategori ishin 1,631.00€, evidentohet një rritje prej 410.00€, përkatësisht 25%.
- **Të hyrat nga shfrytëzimi i rrjetit TU** – si komponentë kryesor i të hyrave operative të NP “INFRAKOS” SH.A., derivojnë nga pagesat për qasje në rrjet nga operatorët e transportit hekurudhor. Në vitin 2025 janë realizuar të hyra në vlerë prej 166,786.00€, që paraqet 2% më pak se buxheti i planifikuar prej 169,554.00€. Krahasuar me vitin 2024, kur këto të hyra ishin 172,714.00€, në vitin 2025 evidentohet një rënie prej 5,928.00€, përkatësisht 3% më pak.
- **Të hyrat nga qiraja** –përbëjnë burimin e dytë më të rëndësishëm të të hyrave të ndërmarrjes. Gjatë vitit 2025 janë realizuar në vlerë prej 1,465,564.00€, që përfaqëson 12% më shumë se buxheti i planifikuar prej 1,308,177.00€, respektivisht një tejkalim prej 157,387.00€. Në krahasim me vitin 2024, kur të hyrat nga qiraja ishin 1,276,135.00€, në vitin raportues evidentohet një rritje prej 189,429.00€, përkatësisht 15%.
- **Të hyrat tjera** – përfshijnë aktivitetet si mirëmbajtja dhe riparimi i binarëve industrial privatë, ofrimi i shërbimeve në terminalin e mallrave (ngarkim dhe shkarkim), si dhe shërbime të tjera përcjellëse. Në vitin 2025 janë realizuar në vlerë prej 178,138.00€, që paraqet 9% më shumë se buxheti i planifikuar prej 162,935.00€. Megjithatë, krahasuar me vitin 2024, kjo kategori ka shënuar rënie të theksuar prej 81%, duke reflektuar ulje të aktiviteteve përkatëse gjatë vitit raportues.
- **Subvencion nga Qeveria e Republikë së Kosovës** – Edhe gjatë vitit 2025 ka vazhduar praktika e viteve paraprake, ku Qeveria e Republikës së Kosovës, pjesërisht ka përmbushur obligimin për mbulimin e diferencës së pagesave nga qasja në rrjet. Në këtë kontekst, vlera totale e subvencioneve të pranuar gjatë vitit 2025 arrin në 775,000.00€, duke mbetur një burim i rëndësishëm i financimit për ndërmarrjen.

Tabela 12: Të hyrat dhe shpenzimet për vitin 2025

Krahasimi i të hyrave dhe shpenzimeve		Realizimi	Realizimi	Buxheti	Diferenca	Diferenca	Diferenca	Diferenca
		2024	2025	2025				
		A	B	C	B - A	B - C	B/A	B/C
TË HYRAT	Të hyrat nga TM	1,631.00	2,041.00	604.00	410.00	1,437.00	125%	338%
	Të hyrat nga TU	172,714.00	166,786.00	169,554.00	(5,928.00)	(2,768.00)	97%	98%
	Të Hyrat nga Qiraja	1,276,135.00	1,465,564.00	1,308,177.00	189,429.00	157,387.00	115%	112%
	Të Hyrat Tjera	931,318.00	178,138.00	162,935.00	(753,180.00)	15,203.00	19%	109%
	Të hyrat e shtyra nga gra. -BK	869,060.00	742,542.00	705,883.00	(126,518.00)	36,659.00	85%	105%
	Sub. për oblig. nga marrveshja me QRKS	1,118,512.00	775,000.00	975,000.00	(343,512.00)	(200,000.00)	69%	79%
	Të hyrat totale	4,369,370.00	3,330,072.00	3,322,153.00	(1,039,299.00)	7,918.00	76%	100%
SHPENZIMET	Pajisjet	32,619.00	16,983.00	40,078.00	(15,636.00)	(23,095.00)	52%	42%
	Harxh. lokal ndërtesave	10,504.00	18,346.00	42,237.00	7,842.00	(23,891.00)	175%	43%
	Energjia elektrike	65,681.00	85,968.00	90,701.00	20,287.00	(4,733.00)	131%	95%
	Nafta	25,421.00	21,248.00	28,506.00	(4,173.00)	(7,258.00)	84%	75%
	Vajrat, lyerësit, etj.	625.00	1,907.00	1,106.00	1,282.00	801.00	305%	172%
	Materiali harxhues oper	48,212.00	82,946.00	154,571.00	34,734.00	(71,625.00)	172%	54%
	Riparimet	7,750.00	7,858.00	47,190.00	108.00	(39,332.00)	101%	17%
	Shërbimet operative	3,346.00	2,111.00	3,506.00	(1,235.00)	(1,395.00)	63%	60%
	Udhëtimet zyrtare	10,997.00	7,213.00	11,859.00	(3,784.00)	(4,646.00)	66%	61%
	Marketingu dhe publikimet	2,010.00	1,262.00	3,529.00	(748.00)	(2,267.00)	63%	36%
	Shkollim/trajnime	27,190.00	1,632.00	3,794.00	(25,558.00)	(2,162.00)	6%	43%
	Mat. i zyrës dhe konsumues	8,649.00	7,598.00	20,567.00	(1,051.00)	(12,969.00)	88%	37%
	Telefoni / mail /interneti	8,845.00	7,944.00	10,164.00	(901.00)	(2,220.00)	90%	78%
	Shpenz. rrezikshmërisë	71,661.00	85,861.00	78,264.00	14,200.00	7,597.00	120%	110%
	Reprezentacioni konsumueset	7,099.00	7,285.00	7,958.00	186.00	(673.00)	103%	92%
	Sigurimi	44,627.00	81,742.00	95,044.00	37,115.00	(13,302.00)	183%	86%
	Stafi i jashtëm	34.00	0.00	3,850.00	(34.00)	(3,850.00)	0%	0%
	Stafi dhe punëtorët	1,810,719.00	1,897,047.00	1,964,729.00	86,328.00	(67,682.00)	105%	97%
	Shpenzimet tjera operative	29,876.00	27,312.00	35,565.00	(2,564.00)	(8,253.00)	91%	77%
	Gjithsej shpenzimet operative	2,215,865.00	2,362,263.00	2,643,218.00	146,398.00	(280,955.00)	107%	89%
1.Diferenca (hyrat -shpenz.) rez. operativ	2,153,506.00	967,810.00	678,935.00	(1,185,696.00)	288,875.00	45%	143%	
2.Shpenzimet e zhvlerësimit	963,846.00	789,540.00	770,693.00	(174,306.00)	18,847.00	82%	102%	
3.Shpenzimet e provizion.B.K	163,713.00	45,688.00	62,000.00	(118,025.00)	(16,312.00)	28%	74%	
4.Shpenzimet e provizion. R.GJ	32,946.00	-	40,000.00	(32,946.00)	(40,000.00)	0%	0%	
5.Shpenzimet tjera financiare	80,225.00	11,116.00	23,689.00	(69,109.00)	(12,573.00)	14%	47%	
6.Shpenzimet e tatimit ne fitim	18,754.00	14,102.00	-	(4,652.00)	14,102.00	-75%	0%	
Rezultati neto (1-2-3-4-5-6)	894,022.00	107,364.00	(217,447.00)	(786,658.00)	324,650.00	12%	-49%	

4.2. Shpenzimet NP "INFRAKOS" SH.A.

Sa i përket shpenzimeve, mund të konstatohet se gjatë vitit 2025 NP "INFRAKOS" SH.A. ka realizuar shpenzime në vlerë prej 3,220,868.00€, që krahasuar me buxhetin e planifikuar prej 3,539,600.00€ paraqet një ulje prej 318,732.00€, përkatësisht 9% më pak se planifikimi. Ky rezultat reflekton një qasje të kujdesshme dhe të kontrolluar në menaxhimin e shpenzimeve gjatë gjithë vitit raportues. Menaxhmenti ka ndërmarrë masa të vazhdueshme për optimizimin e kostove, duke marrë parasysh edhe mosrealizimin e plotë të të hyrave të planifikuara. Si rezultat, është zbatuar një politikë kursimi, e cila ka ndikuar në ruajtjen e stabilitetit financiar të ndërmarrjes. Në krahasim me vitin 2024, kur shpenzimet e realizuara ishin 3,475,349.00€, në vitin 2025 evidentohet një ulje prej 254,481.00€, përkatësisht 7% më pak. Megjithatë, duhet theksuar se kjo qasje konservative në shpenzime ka sjellë edhe sfida operative, përfshirë kufizime në furnizimin me materiale dhe pjesë rezervë. Përkundër këtyre sfidave, ndërmarrja ka arritur të ruajë funksionalitetin dhe nivelin e kërkuar të sigurisë në transportin hekurudhor.

4.3. Krahasimi i shpenzimeve dhe të hyrave

Bazuar në të dhënat financiare për vitin 2025, të hyrat totale të realizuara arrijnë në 3,330,072.00€, të cilat krahasuar me buxhetin e planifikuar prej 3,322,153.00€ rezultojnë me një tejkalim minimal prej 7,918.00€, përkatësisht rreth 0.2% mbi planifikimin. Megjithatë, në krahasim me vitin 2024, kur të hyrat totale ishin 4,369,370.00€, në vitin 2025 evidentohet një rënie e konsiderueshme prej 1,039,299.00€, përkatësisht 24% më pak. Kjo rënie reflekton varësinë strukturore të ndërmarrjes nga operatorët e transportit hekurudhor, nga të cilët gjenerohet pjesa më e madhe e të hyrave, duke kufizuar ndikimin e drejtpërdrejtë të menaxhmentit në rritjen e tyre. Sa i përket shpenzimeve, ato janë realizuar në vlerë prej 3,220,868.00€, që është 9% më pak se buxheti i planifikuar dhe 7% më pak krahasuar me vitin paraprak. Kjo ulje është rezultat i politikave të kursimit dhe kontrollit të shpenzimeve të zbatuara gjatë gjithë vitit, me qëllim ruajtjen e stabilitetit financiar të ndërmarrjes.

Diferenca ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve për vitin 2025 rezulton pozitive në vlerë prej 109,204.00€, duke reflektuar një rezultat financiar të qëndrueshëm në kushte sfiduese operative. Gjithashtu, gjatë këtij viti është realizuar provizionimi i llogarive të arkëtueshme në vlerë prej 45,688.00€, në përputhje me parimet e kujdesit financiar dhe raportimit korrekt.

Në përfundim, viti 2025 karakterizohet si një vit sfidues për INFRAKOS SH.A., kryesisht për shkak të rënies së të hyrave, por njëkohësisht edhe i qëndrueshëm në aspektin financiar, falë menaxhimit të kujdesshëm të shpenzimeve dhe masave të ndërmarra për ruajtjen e funksionalitetit dhe sigurisë së operacioneve hekurudhore.

4.4. Pasqyrat Financiare 2025

"INFRAKOS SHA" Nr. Unik: 811415620 Adresa: Sheshi I Lirisë nr.36

Paqyra e pozitës financiare

Më 31.12.2025

PASURITË	Shënimi	2025	2024
Pasuritë afatshkurtra		€	€
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	4	755,092	934,584
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	5	2,536,860	2,432,573
Stoqet	6	713,264	725,140
Pasuritë e tjera afatshkurtra	7	2,109,617	103,050
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		6,114,832	4,195,347
Pasuritë afatgjata			
Prona, pajisjet dhe impiantet		14,482,037	14,382,806
Investimi në vijim		124,692,179	102,438,420
Gjithsej pasuritë afatgjata	8	139,174,216	116,821,225
Gjithsej pasuritë		145,289,048	121,016,573
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	12	186,070	51,337
Grantet e shtyera	13	55,497,142	46,997,945
Tatimet dhe kontrib.pens.te pagushme	14	837,103	1,112,887
Detyrime të tjera afatshkurte	15	8,358,990	2,059,134
Provizione per raste gjyqsore	16	-	32,946
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		64,879,305	50,254,248
Detyrimet afatgjata			
Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjatë	17	67,982,348	58,442,293
Gjithsej detyrimet afatgjata		67,982,348	58,442,293
Gjithsej detyrimet		132,861,653	108,696,541
EKUITETI			
Kapitali i aksionar	9	25,000	25,000
Fitimet e mbajtura	10	(2,930,984)	(3,825,006)
Rezervat Rivlersimit	11	15,226,015	15,226,015
Fitimi i vitit		107,364	894,022
Gjithsej ekuiteti		12,427,395	12,320,031
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		145,289,048	121,016,573

Këto Pasqyra Financiare u miratuan nga Menaxhmenti dhe Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes me 26 Mars 2026

Bujar Jupaj

Syleme Ahmeti Billaca

Kryeshef Ekzekutiv¹³

Zyrtare Kryesore Financiare dhe Thesarit

¹³ Z. Bujar Jupaj, është përzgjedhur Kryeshef Ekzekutiv sipas Vendimi Nr. Prot. 2/28 të Bordit të Drejtorëve të datës 18.03.2026 dhe Kontratës 2/29 të punës të datës 23.03.2026. Nënshkrimi i të njëjtit është vetëm procedurë e paraparë me ligj, kurse i njëjti nuk mban përgjegjësi për Pasqyrat Financiare 2025.

"INFRAKOS SHA" Nr. Unik: 811415620 Aderesa:Sheshi I Lirisë nr.36**Paqyra e të ardhurave gjithëpërshirëse për vitin që përfundon****Më 31.12.2025**

	Shënimi	2025	2024
		€	€
Të hyrat		2,409,392	2,568,992
Të hyrat tjera afariste		178,138	931,318
Të hyrat nga grantet		742,542	869,060
Të hyrat operative	18	3,330,072	4,369,371
Të ardhurat tjera			
Shpenzimet e pagave	19	(1,897,047)	(1,810,719)
Shpenzimet administrative & tjera	20	(465,215)	(405,146)
Shpenzimet e zhvlersimit	21	(789,540)	(871,500)
Shpenzimet e zhvlersimit te stokut	21.1	-	(92,346)
Shpenzimet e provizionimit borxheve te kqija	22	(45,688)	(163,713)
Shpenzime e provizionimit per raste gjyqsore	23	-	(32,946)
Shpenzimet operative		(3,197,490)	(3,376,370)
Shpenzimet financiare	24	(11,116)	(80,225)
Fitimi/ (humbja) para tatimit		121,466	912,776
Shpenzimet e tatimit në fitim		(14,102)	(18,754)
Fitimi/ (humbja) i/e vitit		107,364	894,022

Shënimet shoqëruese nga faqja 18 deri në 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

"INFRAKOS SHA" Nr. Unik: 811415620 Aderesa: Sheshi I Lirisë nr.36
Paqyra e rrjedhjes së parasë për vitin që përfundon
Më 31.12.2025

Shënim	2025 €	2024 €
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi / (humbja) i / e vitit	107,364	894,022
<i>Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave</i>	-	(29,542)
Zhvlërësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	789,540	871,500
Shpenzimet financiare	11,116	80,225
Shpenzimet e tatimit në fitim	-	-
	<u>908,019</u>	<u>1,816,205</u>
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative		
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	(2,110,854)	(726,726)
(Rritja) / zvogëlimi në stocqe	11,877	92,183
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	134,732	3,879
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera	5,991,126	1,934,651
Rritja / (zvogëlimi) në grante	8,499,198	6,917,097
	<u>13,434,098</u>	<u>10,037,288</u>
Tatimi në fitim i paguar	-	-
Interesi i paguar	(11,116)	(80,225)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative	<u>13,422,982</u>	<u>9,957,063</u>
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Pagesat për blerjet e pronës, dhe asetëve tjera	(888,771)	(83,493)
Investime ne projekte kapitale	(22,253,759)	(17,408,210)
Neto rrjedha nga aktivitetet investuese	<u>(23,142,530)</u>	<u>(17,491,703)</u>
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financiare		
Terheqjet		
Ndryshimi ne huazime	9,540,056	7,886,461
Neto rrjedha nga aktivitetet financiare	<u>9,540,056</u>	<u>7,886,461</u>
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë	(179,492)	351,821
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	934,584	582,763
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	<u>755,092</u>	<u>934,584</u>

Shënimet shoqëruese nga faqja 18 deri në 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

"INFRAKOS SHA" Nr. Unik: 811415620 Aderesa:Sheshi I Lirisë nr.36

Paqyra e ndryshimeve në ekuitet për vitin që përfundon

Më 31.12.2025

	Rishikuar			Gjithsej
	Kapitali I pronarit	Fitimet e mbajtura	Rezervat e tjera	
	€	€	€	
Gjendja më 1 janar 2024	25,000	(3,795,464)	15,226,015	11,455,551
Fitimi / (humbja) i/e vitit		894,022		894,022
Terheqje Kapitalit/deponim		(29,542)		(29,542)
Korrigjim i fitimit te mbajtur		-		-
Gjendja më 31 dhjetor 2024	25,000	(2,930,984)	15,226,015	12,320,031
Fitimi / (humbja) i/e vitit		107,364		107,364
Terheqje Kapitalit/deponim	-			-
Gjendja më 31 dhjetor 2025	25,000	(2,823,620)	15,226,015	12,427,395

Shënimet shoqëruese nga faqja 18 deri në 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

4.5. Shpenzimet kapitale dhe projektet

Me anë të kësaj përmbledhje paraqitet aktiviteti i Zyrës për Prokurim Publik gjatë vitit fiskal 2025, përkatësisht për periudhën 01 janar – 31 dhjetor 2025, me fokus të veçantë në realizimin e projekteve kapitale dhe menaxhimin e shpenzimeve kapitale.

Raporti i prokurimit në përmbajtjen e tij paraqet, në mënyrë analitike, të dhënat për kontratat publike të nënshkruara, ndarjen e tyre mbi bazën e llojit të procedurave të përdorura nga Autoriteti Kontraktues, nivelin e përdorimit të këtyre procedurave, nivelin e konkurrencës në tregun publik, si dhe indikatorë të tjerë të rëndësishëm. Përmes këtyre të dhënave dhe analizës së indikatorëve përkatës, është mundësuar një vlerësim më i plotë i performancës së prokurimit dhe ndikimit të tij në realizimin e projekteve të planifikuara.

Zyra për Prokurim Publik, gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj, ka pasur si objektiv të vazhdueshëm respektimin e parimeve bazë të Ligjit për Prokurimin Publik, siç janë economiciteti (vlera për paranë), trajtimi i barabartë dhe mos diskriminimi, efikasiteti dhe transparencja, duke siguruar kështu një proces të drejtë dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të fondeve publike. Gjatë vitit 2025, Zyra e Prokurimit ka iniciuar gjithsej 33 procedura të prokurimit dhe ka nënshkruar 30 kontrata për furnizime dhe shërbime, me qëllim përmbushjen e kërkesave të të gjitha njësisve kërkuese dhe realizimin e projekteve të parapara. Këto procedura kanë qenë të orientuara në mënyrë të konsiderueshme drejt mbështetjes së projekteve kapitale dhe investimeve në infrastrukturën hekurudhore. Projektet e realizuara përmes këtyre procedurave janë financuar nga:

- ❖ Buxheti i Republikës së Kosovës (projektet kapitale);
- ❖ Buxheti i NP “INFRAKOS” SH.A.

Në kuadër të shpenzimeve kapitale, aktivitetet e prokurimit kanë kontribuar në realizimin e investimeve që ndërlidhen me mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore, si dhe në sigurimin e kushteve për funksionim të qëndrueshëm dhe të sigurt të operacioneve. Menaxhimi i këtyre projekteve është karakterizuar nga një qasje e kujdesshme financiare, duke synuar përdorimin sa më efikas të mjeteve në dispozicion dhe përmbushjen e objektivave të planifikuara.

Në përgjithësi, gjatë vitit 2025, aktivitetet e prokurimit publik kanë pasur rol thelbësor në realizimin e shpenzimeve kapitale dhe avancimin e projekteve strategjike të ndërmarrjes, duke kontribuar drejtpërdrejt në përmirësimin e infrastrukturës dhe rritjen e performancës operative.

Gjatë vitit raportues, nga Buxheti i Kosovës përmes Ministrisë së Ekonomisë, për NP “INFRAKOS” SH.A. janë ndarë 200,000.00€ për financimin e projekteve kapitale. Nga këto fonde, janë realizuar 5 projekte kapitale me vlerë totale prej 147,443.24€, ndërsa një projekt i gjashtë, me kontratë në shumë prej 30,000.00€, nuk është përfunduar brenda afatit kontraktual. Në përputhje me marrëveshjen e Ministrisë së Ekonomisë, janë nënshkruar gjithsej 6 kontrata për projekte kapitale të financuara nga kjo ministri. Nga këto, 5 projekte janë përfunduar, ndërsa 1 projekt mbetet në proces. Krahasimi mes vlerës së parashikuar dhe të kontraktuar tregon një kursim prej 22,556.76€, që reflekton menaxhim të kujdesshëm

financiar dhe përdorim efikas të fondeve të ndara për projektet kapitale. Në formë tabelare paraqiten të dhënat e detajuara për secilin projekt, duke përfshirë statusin e realizimit dhe vlerën e kontraktuar.

Tabela 13: Projektet kapitale të zhvilluara nga buxheti i Republikës së Kosovës

Viti 2025	Numri i Projekteve kapitale sipas marrëveshjeve	Vlera e paraparë në €	Vlera e kontraktuar në €	Diferenca mes Mjeteve të Planifikuara dhe të Kontraktuara në €
Marrëveshjet sipas Ministrive				
Marrëveshja e Ministrisë së Ekonomisë	6	200,000.00	177,443.24	22,556.76

Gjatë vitit 2025, nga buxheti vetanak i NP "INFRAKOS" SH.A. janë financuar dhe realizuar gjithsej 24 projekte kapitale. Krahasimi mes vlerës së parashikuar prej 160,382.62€ dhe vlerës së kontraktuar prej 152,603.27€ tregon një kursim prej 7,779.35€, që reflekton menaxhim të kujdesshëm financiar dhe përdorim efikas të fondeve të ndërmarrjes. Projektet e pa përfunduara gjatë vitit kanë një vlerë të parashikuar prej 6,234.05€, duke mbetur në proces për finalizim në periudhat e ardhshme.

Tabela 14: Projekte kapitale të zhvilluara nga buxheti NP "INFRAKOS" SH.A.

Viti 2025	Numri i Projekteve sipas buxhetit të INFRAKOS	Vlera e paraparë në €	Vlera e kontraktuar në €	Diferenca mes mjeteve të planifikuara dhe të kontraktuara në €
	24	160,382.62	152,603.27	7,779.35

Gjatë vitit 2025, janë iniciuar gjithsej 33 aktivitete të prokurimit, për të cilat njësitë kërkuese kanë përgatitur dhe paraqitur kërkesat për inicim, me një vlerë të parashikuar totale prej 366,616.67€. Nga këto aktivitete, gjatë vitit janë nënshkruar kontratat përkatëse, duke përfshirë furnizime dhe shërbime të nevojshme për funksionimin e ndërmarrjes. Krahasimi ndërmjet vlerës së parashikuar dhe vlerës së kontraktuar tregon një kursim prej 30,335.11€, që reflekton një menaxhim të kujdesshëm financiar dhe përdorim efikas të fondeve gjatë procesit të prokurimit. Këto rezultate dëshmojnë se aktivitetet e prokurimit janë zhvilluar në përputhje me planifikimin dhe objektivat e vitit, duke ruajtur efikasitetin dhe ekonomikitetin në shpenzimet e ndërmarrjes.

Prokurimet për të përmbushur nevojat e Autoritetit Kontraktues, shprehur në vlerë financiare, janë realizuar kryesisht përmes procedurës së hapur e cila garanton shkallën më të lartë të transparencës dhe konkurrencës mes operatorëve ekonomikë në krahasim me procedurat e tjera të prokurimit. Nga analiza e të dhënave rezulton se procedura e hapur ka zënë 88.74 për qind të vlerës së përgjithshme të parashikuar të prokurimeve, ndërsa procedura e kuotimit të çmimeve ka zënë 9.93 për qind. Kursimet më të mëdha janë realizuar përmes procedurës së hapur, për shkak të përqendrimit të mjeteve më të mëdha financiare në këto prokurime. Gjatë vitit 2025 janë përdorur dy lloje kryesore prokurimesh, furnizime dhe shërbime, ku pjesëmarrja e tyre në vlerën e kontraktuar është respektivisht 65.96 për qind për furnizimet dhe 34.04 për qind për shërbimet.

Për vonesa të paarsyeshme në përfundimin e projekteve sipas planit dinamik të kontraktuar, Zyra e Prokurimit ka aplikuar penale financiare në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe kushtet e kontratës, me një vlerë totale prej 250.24 euro, duke reflektuar kujdesin për zbatimin korrekt të kontratave dhe disiplinimin e afateve.

Tabela 15: Procedurat e zhvilluara në Prokurim Publik

Mjetet Financiare	Procedurë e hapur (€)	Procedurë e kuotimit të cmimeve (€)	Procedurë e kuotimit për prokurimet të vlerës minimale (€)	Gjithsej (€)
Të parashikuara	319,813.00€	35,791.70€	4,777.92€	360,382.62€
Të kontraktuara	296,528.20€	28,860.74€	4,657.57€	330,046.51€
Diferenca	23,284.80€	6,930.96€	120.35€	30,336.11€
Pjesëmarrja në %, sipas procedurës	88.74%	9.93%	1.33%	100%

Tabela 16: Llojet e prokurimeve të zhvilluara në Prokurim Publik

Viti 2025	Mjete financiare të parashikuara	Mjete financiare të kontraktuara	Pjesëmarrja në % në vlerën e përgjithshme të kontraktuar
Furnizime	243,758.73€	217,693.93€	65.96%
Shërbime	116,623.89€	112,352.58€	34.04%
Gjithsej	360,382.62€	330,046.51€	100%

MENAXHIMI I RREZIQEVE

Procesi i menaxhimit të rreziqeve brenda Ndërmarrjes Publike "Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës – INFRAKOS" SH.A. gjatë vitit 2025 ka qenë një sfidë komplekse që ka kërkuar një angazhim të pashembullt institucional. Sfidat të cilat e kanë përcjellë NP "INFRAKOS" SH.A. në vitet e kaluara, e sidomos ato të vazhduara edhe gjatë këtij viti raportues, kanë qenë tejet të mëdha, veçanërisht sa i përket qëndrueshmërisë dhe gjendjes financiare të ndërmarrjes.

Përkundër kësaj, analizat tona të detajuara tregojnë se rreziqet në vitet e ardhshme vazhdojnë të jenë të ndikuara dhe të varura nga një sërë faktorësh të jashtëm, në shumicën e të cilëve ndikimi i drejtpërdrejtë i NP "INFRAKOS" SH.A. është fatkeqësisht shumë i vogël apo pothuajse zero. Kjo situatë dikton nevojën që, përveç përpjekjeve tona të brendshme, të ketë një angazhim urgjent dhe të koordinuar edhe nga institucionet e tjera relevante, si Ministria e Infrastrukturës, si dhe Ministria e Ekonomisë. Vetëm përmes një fronti të përbashkët institucional mund të arrihet që rreziqet në infrastrukturën hekurudhore të eliminohen tërësisht apo të zvogëlohen maksimalisht, në mënyrë që rrjeti hekurudhor i Republikës së Kosovës të arrijë nivelin e duhur të sigurisë dhe efikasitetit për ofrimin e shërbimeve cilësore.

Në rrafshin financiar, rreziku kryesor mbetet mos përmbushja e plotë e obligimeve që rrjedhin nga marrëveshjet me Qeverinë e Republikës së Kosovës, ku gjatë vitit 2025 është vërejtur një mospërputhje mes mjeteve të planifikuara dhe atyre të alokuara, gjë që vë në vështirësi mbulimin e shpenzimeve operative dhe pagave të personelit. Ky rrezik shoqërohet ndjeshëm edhe me aspektin ligjor, ku ndërmarrja përballet me një numër të madh lëndësh gjyqësore aktive që kapin vlera të larta financiare, duke krijuar një pasiguri të vazhdueshme për buxhetin e ndërmarrjes. Menaxhimi i këtyre kontesteve kërkon jo vetëm përfaqësim profesional ligjor, por edhe një mbështetje më të madhe buxhetore për të evituar bllokimin e mundshëm të llogarive nga vendimet përfundimtare gjyqësore.

Njëkohësisht, rreziku operacional lidhur me sigurinë në trafik paraqet një shqetësim serioz, veçanërisht pas rritjes së numrit të aksidenteve në vendkalimet hekurudhore gjatë vitit 2025. Ky fenomen dëshmon se rreziku nuk buron vetëm nga gjendja teknike e infrastrukturës, por edhe nga faktorë të jashtëm si mungesa e vetëdijesimit të qytetarëve dhe nevoja për investime më të mëdha në sinjalizim dhe mbrojtje fizike të kryqëzimeve. Gjithashtu, zbatimi i projekteve kapitale, si rehabilitimi i Linjës 10, mbart rreziqe që ndërlidhen me vonesat në planet dinamike, ku NP "INFRAKOS" SH.A. ka aplikuar masa disiplinore dhe penale ndaj kontraktorëve për të mbrojtur interesat e ndërmarrjes dhe për të garantuar përfundimin e punimeve brenda afateve të parapara. Në fund, menaxhimi i suksesshëm i këtyre rreziqeve mbetet i lidhur ngushtë me modernizimin e infrastrukturës dhe mbështetjen e vazhdueshme të Aksionarit për të transformuar hekurudhën në një mjet transporti konkurrues dhe të sigurt.

PËRMBUSHJA E PLANIT TË BIZNESIT

Realizimi i Planit të Biznesit për vitin 2025 shënon një periudhë stabiliteti relativ për NP "INFRAKOS" SH.A., pavarësisht faktit që ndërmarrja ka operuar në një ambient të kushtëzuar nga punimet kapitale në infrastrukturë dhe luhatjet e transportit të mallrave. Gjatë këtij viti, prioriteti kryesor i menaxhmentit ka qenë balancimi i shpenzimeve operative me të hyrat e realizuara, duke synuar qëndrueshmërinë financiare përmes diversifikimit të burimeve të të hyrave. Një arritje e veçantë që vlen të theksohet është performanca e Sektorit të Pronës, i cili ka tejkaluar parashikimet fillestare, duke shërbyer si shtyllë mbajtëse për likuiditetin e ndërmarrjes në periudhat kur të hyrat nga qasja në rrjet ishin nën nivelin e pritur. Në aspektin e të hyrave operative, viti 2025 u mbyll me një realizim prej 3,330,072€, shifër kjo që jo vetëm përmbush, por edhe tejkalon minimalisht planifikimin buxhetor prej 3,322,153€. Ky sukses financiar është rezultat i një menaxhimi rigoroz të kontratave të qirasë dhe rritjes së efijencës në mbledhjen e mjeteve. Të hyrat nga qiraja kanë arritur vlerën prej 1,465,564€, që paraqet një rritje prej 12% në krahasiv me planin dhe 15% më shumë se në vitin paraprak. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i menaxhimit të rreth 377 kontratave aktive dhe shpalljeve publike për dhënie të pronës me qira, duke treguar një angazhim proaktiv në maksimizimin e vlerës së asetëve që nuk përdoren drejtpërdrejt për operime hekurudhore. Nga ana tjetër, transporti i mallrave dhe udhëtarëve ka reflektuar sfidat teknike të rrjetit. Edhe pse të hyrat nga trenat e mallrave kanë shënuar një tejkalim të planit në vlerë absolute, ato mbeten akoma larg potencialit të tyre të plotë për shkak të shpejtësisë së kufizuar në 60 km/h në pjesën më të madhe të linjave. Sidoqoftë, sektori i transportit të udhëtarëve ka treguar qëndrueshmëri, duke realizuar 98% të planit me një vlerë prej 166,786€. Kjo performancë dëshmon rëndësinë sociale që ka hekurudha për qytetarët e Kosovës dhe nevojën për investime të mëtutjeshme në rritjen e cilësisë së shërbimit. Mbështetja nga Aksionari përmes subvencioneve ka qenë e rëndësishme, ndonëse realizimi prej 79% të vlerës së planifikuar (775,000€ nga 975,000€) ka kërkuar një rishpërndarje të kujdesshme të brendshme të fondeve për të mbuluar të gjitha obligimet kontraktuale dhe pagat e punonjësve.

Për më tepër, Rehabilitimi i Linjës 10 mbetet gurthemeli i transformimit të ndërmarrjes. Ndonëse këto projekte menaxhohen me mbështetjen e institucioneve financiare ndërkombëtare, NP "INFRAKOS" SH.A. ka luajtur një rol kyç në mbikëqyrjen teknike dhe sigurimin që punimet të ecin sipas standardeve evropiane të sigurisë dhe ndërveprueshmërisë. Menaxhimi i shpenzimeve ka qenë po aq prioritar sa rritja e të hyrave. Shpenzimet totale të realizuara prej 3,220,868€ janë për 9% më të ulëta se ato të planifikuara, gjë që pasqyron një politikë të suksesshme të racionalizimit të kostove operative pa cenuar sigurinë e operimeve. Ky kursim ka ardhur kryesisht nga optimizimi i proceseve të prokurimit dhe kontrolli i rreptë mbi shpenzimet administrative. Përdorimi i procedurave të hapura në mbi 65% të vlerës së kontraktuar në prokurim dëshmon për një transparencë të shtuar dhe përpjekje për të siguruar vlerën më të mirë për paratë e shpenzuara. Në kuadër të zhvillimit të burimeve njerëzore, plani i biznesit ka paraparë dhe realizuar programe të vazhdueshme trajnimiti, duke arritur mbi 900 orë trajnim për stafin në fusha si siguria në punë dhe prokurimi publik. Kjo rritje e kapaciteteve njerëzore është e domosdoshme për fazën e ardhshme të zhvillimit të hekurudhës, ku teknologjitë e reja që po instalohen në Linjën 10 do të kërkojnë njohuri të avancuara teknike. Në përfundim, viti 2025 mund të konsiderohet si një vit ku NP "INFRAKOS" SH.A. ka arritur të tejkalojë objektivin e fitimit operativ, duke mbyllur vitin me një diferencë pozitive prej 109,204€, rezultat ky që forcon pozicionin e ndërmarrjes si një subjekt i qëndrueshëm dhe i gatshëm për sfidat e modernizimit të mëtutjeshëm.